SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE

Akademia për pushtetin vendor

Opinioni i Shoqatës për Autonomi Vendore
Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 6, datë 12/01/2024

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive e Opinionit të SHAV ---------- 3

Hyrje ---------- 4

Metodologjia ---------- 4

E drejta për forcim kapacitetesh ---------- 5

ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) ---------- 7

Propozimi për ngritjen e Akademisë ---------- 8

Grupi tematik ---------- 9

Grupi politik ---------- 10

Struktura drejtuese ---------- 12

Objekti i veprimtarisë ---------- 13

Avantazhet Akademi vs ASPA ---------- 14

Bashkëpunimi dhe partneriteti ---------- 14

Qëndrueshmëria financiare ---------- 15

Faza tranzitore ---------- 16

Përmbledhje ekzekutive

Në përfundim të një procesi të gjatë konsultimi gjithëpërfshirës me të zgjedhur vendorë, punonjës me eksperiencë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësues të Drejtorive Juridike dhe Drejtorive të Administratës Publike të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me ekspertë dhe aktorë të tjerë lokalë dhe qendrorë, Shoqata për Autonomi Vendore prezanton opinioni e të zgjedhurve vendorë si vijon :

- Përshëndet iniciativën për ngritjen e Akademisë për Pushtetin Vendor me qëllim forcimin e kapaciteteve të administratës vendore dhe të zgjedhurve vendorë.
- Propozon që forma e organizimit të Akademisë të jetë një Agjenci ose OJF me organ vendimmarrës një Këshill Mbikqyrës / Bord me përbërje të aktorëve qendrorë dhe vendorë me veprimtari në fushën e forcimit të kapaciteteve, si dhe me organin e vet ekzekutiv të zgjedhur nga organi vendimmarrës.
- Shoqata / shoqatat e të zgjedhurve vendorë të mund të zotërojnë shumicën në organin vendimmarrës të Akademisë me qëllim garantimin e autonomisë vendore dhe përputhshmërinë me objektin e veprimtarisë së Akademisë.
- Drejtimi i Këshillit Mbikqyrës / Bordit të mund të jetë me rrotacion ndërmjet anëtarëve përfaqësues të institucioneve dhe aktorëve pjesëmarrës.
- Objekti i veprimtarisë së Akademisë të jetë kryesisht, po pa u kufizuar vetëm në:
  - → Kualifikimi profesional periodik i të zgjedhurve vendorë me mandat 4-vjecar (Kryetarë dhe Këshilltarë të Këshillave Bashkiake)
  - → Kualifikimi periodik i administratës publike me status të nëpunësit civil
  - → Kualifikimi periodik i drejtuesve të institucioneve dhe ndërmarrjeve në vartësi të bashkive.
  - → Promovimi i praktikave të mira, shkëmbimi i eksperiencave, unifikimi i standarteve dhe mbështetja e individualitetit të cdo bashkie.
- Në veprimtarinë e vet Akademia bashkëpunon dhe koordinon me AMVV, SHAV, SHKQSH, DAP, ASPA dhe të gjithë aktorët vendas dhe të huaj me kontribut në forcimin e kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë dhe qendrore.
- Mbështetja financiare e Akademisë do të mund të garantohet nga kontributi i Bashkive , i Qeverisë Qendrore dhe donatorëve. Bashkitë mund të mbështesin financiarisht të paktën 60 % të buxhetit të Akademisë duke ndarë kontributin mes tyre në përputhje me numrin e punonjësve të administratës.
- Forma e organizimit dhe mënyra e funksionimit të Akademisë do të duhet të përcaktohen në aktin e themelimit dhe statutin e saj, ose me Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Hyrje

Krijimi i Akademisë për pushtetin vendor lindi si një nevojë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për forcim kapacitetesh, zgjerim të gamës së trajnimeve dhe përfshirje në programet e kualifikimit profesional edhe të kategorive të tjera që nuk janë pjesë e shërbimit civil sic është rasti i drejtuesve dhe administratës së disa institucioneve dhe ndërmarrjeve në vartësi të bashkive.

Rasti i këshilltarëve të zgjedhur për herë të parë si pjesë e këshillave bashkiake dhe nevoja e tyre për njohje të legjislacionit, të kompetencave të NJVQV dhe mënyrës së funksionimit të tyre, kërkon gjithashtu realizimin e seancave trajnuese me qëllim aftësimin e tyre për të luajtur rolin e vendimmarrësit, përfaqësuesit të komunitetit dhe monitoruesit të veprimtarisë së ekzekutivit.

Reforma Administrativo-Territoriale që reduktori numrin e NJVQV nga 373 në 61 Bashki ka krijuar mundësi reale për përfshirjen e më shumë pjestarëve të administratës vendore në programet kualifikuese. Nga ana tjetër, procesi i decentralizimit të funksioneve të reja drejt vetëqeverisjes vendore, ka krijuar sfida të reja për ofrimin për herë të parë të shërbimeve shtesë ndaj komunitetit , por edhe ka rritur ndjeshëm numrin e punonjësve të NJVQV.

Autonomia vendore dhe karakteristikat specifike të 61 bashkive të reja e bëjnë të vështirë unifikimin e praktikave të drejtimit dhe menaxhimit të tyre si dhe standardizimin e ofrimit të shërbimeve ndaj komunitetit. Gjithsesi, shkëmbimi i përvojave pozitive dhe historive të suksesit, mund të shërbejë si celësi i afrimit të bashkive drejt objektivave të përbashkëta dhe rrugëve të arritjes së tyre.

Megjithë përpjekjet e ASPA dhe të shoqatave të të zgjedhurve vendorë, nevojat për forcim kapacitetesh, shkëmbim përvojash dhe standartizim, vazhdojnë të mbeten një nga sfidat kryesore të vetëqeverisjes vendore.

Urdhëri i Kryeministrit me nr. 6 datë 12.01.2024 adreson pikërisht këtë nevojë dhe i hap rrugën krijimit të Akademisë së pushteti vendor, e cila jo vetëm do të plotësojë nevojat e NJVQV, por do të mund të lehtësojë rolin e ASPA dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë, duke luajtur një rol komplementar në forcimin e kapaciteteve të të gjitha kategorive të administratës dhe të zgjedhurve vendorë.

Metodologjia

Ky dokument shpreh opinionin e Shoqatës për Autonomi Vendore në lidhje me krijimin, organizimin dhe funksionimin e Akademisë së pushtetit vendor.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti ka vlerësuar hapat si vijon :

→ Studimi i legjislacionit në fushën e administratës publike dhe detyrimin për plotësimin e nevojave për kaulifikim të saj.

→ Shqyrtimi i Urdhërit të Kryeministrit me nr. 6 datë 12/1/2024
→ Ngritjen e dy grupeve të punës për administrimin e procesit
  ✓ Grupi i punës tematik
  ✓ Grupi i punës politik
→ Kontraktimi i një eksperti për cështjet vendore me qëllim asistimin e procesit.
→ Realizimin e takimeve të grupit tematik, diskutimi, marrrja e rekomandimeve dhe prezantimi i tyre në takimin e grupit politik
→ Organizimin e takimeve të grupit politik për dhënien e rekomandimev dhe diskutimin e opsioneve të mundëshme të krijimit dhe funksionimit të Akademisë.
→ Diskutimi i opinioneve të pjestarëve të grupit politik me ekspertë dhe aktorë të fushës dhe hartimi i një përmbledhje rekomandimesh të dakordësuara.
→ Hartimin e draft-dokumentit paraprak me rekomandime në lidhje me krijimin e Akademisë për Pushtetin Vendor.
→ Dërgimi i draft-opinionit tek të gjithë anëtarët e SHAV si dhe tek drejtues të tjerë të administratës vendore për vlerësim
→ Plotësimi i draftit paraprak me rekomandimet e dhëna
→ Diskutimi dhe miratimi i Opinionit përfundimtar në strukturat drejtuese të SHAV

E drejta për forcim kapacitetesh

E drejta për forcim kapacitetesh të administratës dhe të zgjedhurve vendorë buron nga disa burime ligjore dhe regullatore, duke përfshirë :
Kushtetuta e RSH - është dokumenti themelor që përcakton strukturën e qeverisjes dhe ndan pushtetet ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

Ligji nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" - regullon funksionimin dhe organizimin e NJVQV duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e tyre, financimin dhe nevojën për forcimin e kapaciteteve të tyre.

Administrata vendore është e strukturuar në institucione vendore të dy niveleve të vetëqeverises vendore:

- Tek strukturat e NJVQV të nivelit të parë që janë Bashkitë, përfshirë Njësitë Administrative, institucionet dhe ndërmarrjet në vartësi.
- Tek strukturat e NJVQV të nivelit të dytë që janë Këshillat e Qarqeve

Bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Organet e NJVQV kanë kompetenca të qartë dhe detyrimet e tyre për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të administratës vendore. Konkretisht:

→ *Këshilli i Bashkisë miraton numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të saj*

→ *Kryetari i Bashkisë miraton strukturën, organikën e kategoritë / klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.*

Forcimi i kapaciteteve të administratës vendore është një nga prioritetet kryesore të drejtuesve vendorë, si nevojë, por edhe si kërkesë e Ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Në Nenin 51 të Ligjit cilësohet e drejta e këshilltarëve të këshillave bashkiake për kualifikim profesional. Konkretisht në pikën 4 të tij shprehet :

….

4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi

Gjithashtu në Nenin 64 të ligjit që ka të bëjë me kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë ndërmjet të tjerave, në pikën "h" përcaktohet që :

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

…

h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"- rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë e administratës vendore, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve përmes përmirësimit të qasjes në informacion.

Strategjitë dhe Planet Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit- janë dokumenta strategjikë që përfshijnë masa për forcim kapacitetesh të administratës vendore si pjesë e reformave të përgjithëshme të qeverisjes publike.

Aktët nënligjore dhe udhëzimet administrative- të nxjerra nga ministritë dhe institucionet e tjera, detajojnë mënyrat dhe proceset për forcimin e kapaciteteve administrative.

Programet dhe projektet e donatorëve- nëpërmjet organizatave të ndryshme ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme kanë ofruar mbështetje teknike dhe financiare për forcimin e kapaciteteve të administratës vendore.

Këto dhe burime të tjera sigurojnë kornizën dhe mbështetjen e nevojshme për forcimin e kapaciteteve të administratës vendore duke mundësuar zhvillimin efektiv të shërbimeve publike dhe qeverisjes së mirë vendorë në Shqipëri.

ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) është një institucion kyç në Shqipëri që luan një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të administratës publike, përfshirë administratën vendore. Disa prej funksioneve dhe kontributeve kryesore të ASPA-s përfshijnë:

→ **Trajnime dhe Kualifikime** : ASPA ofron programe të ndryshme trajnimi për punonjësit e administratës publike dhe vendore, duke përfshirë kurse për menaxhimin e burimeve njerëzore, financat publike, qeverisjen e mirë, dhe shërbimet publike.
→ **Certifikime**: ASPA ofron certifikata për punonjësit e administratës pas përfundimit të programeve specifike të trajnimit, duke rritur kualifikimet e tyre dhe kapacitetet profesionale.
→ **Hulumtime dhe Studime**: ASPA kryen hulumtime dhe studime që ndihmojnë në zhvillimin e politikave dhe praktikave më të mira për administratën publike dhe vendore.
→ **Partneritete dhe Bashkëpunime**: ASPA bashkëpunon me institucione ndërkombëtare dhe organizata donatore për të sjellë praktikat më të mira dhe për të siguruar burimet e nevojshme për forcimin e kapaciteteve.
→ **Burime dhe Materiale Edukative**: ASPA publikon manuale, udhëzues, dhe materiale të tjera edukative që janë të disponueshme për punonjësit e administratës publike dhe vendore.
→ **Platforma e Mësimit Online**: ASPA ka zhvilluar edhe platforma online që lehtësojnë qasjen në materialet e trajnimit dhe mundësojnë mësimin e vazhdueshëm për punonjësit e administratës.

Përmes këtyre aktiviteteve, ASPA kontribuon në përmirësimin e efektivitetit, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike dhe vendore në Shqipëri, duke u siguruar që punonjësit kanë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë të suksesshme.

Veprimtaria e ASPA bazohet në Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike" dhe Vendimin Nr. 138, datë 12.3.2014 "Për regullat e organizimit dhe të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civile" (Ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.349, datë 4.6.2014 dhe nr.70, datë 27.1.2016
VKM përcakton strukturat drejtuese të ASPA si dhe objektin e veprimtarisë së saj. Objekti i veprimtarisë së ASPA parashikon ofrimin e trajnimeve të thelluara pa pagesë për nëpunës të shërbimit civil dhe orfimin e trajnimeve të thelluara me pagesë për nëpunës jashtë shërbimit civil.
Ndërkohë qe e para është realizuar pjesërisht në mbështetje të përfitimit të statusit të nëpunësit civil nga ana e administratës vendore, kjo e fundit, pra trajnimet me pagesë për nëpunës jashtë shërbimit civil, përgjithësisht nuk ka funksionuar. Punonjësit e NJVQV pa status të nëpunësit civil, nuk kanë qënë objekt i trajnimeve të realizuara nga ASPA.
Akoma më pak, trajnimet për të zgjedhurit vendorë nuk janë konsideruar në asnjë moment nga ana e ASPA. Kontributi i Projektit Bashki të Forta ka plotësuar vitet e fundit nevojën për kualifikime periodike

dhe aftësim të këshilltarëve të zgjedhur në këshillat bashkiake, duke krijuar jo vetëm kurrikulat bazë të forcimit të kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë, por edhe duke hedhur themelet bazë për vijimin e punës në të ardhmen.

Edhe vetë trajnimet e ofruara nga ASPA për nëpunësit vendorë, kanë qënë të kufizuara mjaftueshëm. ASPA e shikon veten përgjegjës vetëm për trajnimet në lidhje me ciklin e detyrueshëm për nënpunësin civil për të zgjedhurit vendorë. Ndërkohë, kur vjen puna për cështje teknike të qeverisjes vendore, ASPA nuk e shikon veten përgjegjëse, duke e konsideruar atë si të pa administrueshme.

Janë 61 bashki me karakteristika specifike, që ushtrojnë të paktën 40 funksione, një numër të madh shërbimesh shumë diverse, dhe ASPA nuk ka qënë asnjëherë gati të përballet me këtë lloj larmishmërie.

Nevojat dhe kërkesat e paplotësuara në fushën e forcimit të kapaciteteve të të zgjedhurve dhe administratës vendore, janë evidente.

Propozimi për ngritjen e Akademisë së pushtetit vendor

Bazuar në konsultimet dhe analizat e paraqitura në dokumentin (Paper) të Qershorit 2023, avantazhet kryesore që konsiderojnë ngritjen e Akademisë janë:

→ Akademia ka më shumë gjasa për të tërhequr mbështetje të gjerë nga palët e interesit dhe nga donatorët
→ Akademia mund të arrijë një profil dhe markë të lartë
→ Akademia konsiderohet më e qëndrueshme dhe me më pak mundësi ndryshimi
→ Akademia do të mund të fokusohet veçanërisht në qeverisjen vendore dhe të trajtojë nevojat e të zgjedhurve dhe të jo të zgjedhurve
→ Akademia ka potencial për zhvillim

Të gjithë aktorët bien dakord për nevojën e ngritjes së Akademisë dhe rolin që ajo duhet të luajë në forcimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe administratës vendore, nëpërmjet përdorimit të formave të larmishme bashkëkohore dhe përdorimin e teknlogjisë në arritjen e objektivave të saj.

Përsa i përket formës së organizimit të saj ka disa opinione, por që në parim klasifikohen në 2 grupime që mbështesin krijimin e Akademisë :

- Në formën e një strukture, që mund të jetë psh një Agjenci shtetërore apo një formë tjetër e ngjashme organizimi
- Në formën e një strukture të pavarur, që mund të jetë një OJF ose një tjetër formë organizimi si pjesë e strukturave të organizatave të të zgjedhurve vendorë.

Në tabelën në vijim paraqiten pikat e forta dhe pikat e dobëta që duhen konsideruar në analizën për përcaktimin e formës së organizimit të Akademisë :

Strukturë shtetërorë	Strukturë e pavarur (OJF, etj)
Pikat e forta	*Pikat e forta*
→ Përgjegjës para Ministrit të PV/AMVV → Me ligjin 90/2012, ose ligj specifik, ose VKM → Financimi bazë i qëndrueshëm shtetëror dhe nga NJVQV-të (sipas formulës) → Koordinimi i trajnimit është më i lehtë → Standardizimi dhe certifikimi i trajnimeve më i kontrolluar → Koordinimi institucional më i fortë se OJQ-të → Më e besueshme për organizatat/institucionet ndërkombëtare (p.sh. BE) → Qasje e lehtë në fondet e BE-së për Admin Publike	→ Sipas ligjit për OJF-të dhe Ministri i PV/AMVV +Shoqatat+të tjera (themeluesit) → Financimi i përbashkët (Qeveri, NJQV, donatorë) → Funksionimi fleksibël i organizatës → Lehtësi për qasje,përdorim të fondeve të donatorëve → Më llogaridhëse ndaj NJQV-ve → Më transparente dhe të audituara → Lehtë për donatorët që të mbikëqyrin llogaritë → Donatorët më të gatshëm për të financuar OJF → Mgn financiar sipas ligjit, rregullave të donatorëve → Donatorët kontrollojnë më lehtësisht financat e OJF → Më e qëndrueshme ndaj ndryshimit të ciklit politik
Pikat e dobëta	*Pikat e dobëta*
→ Më pak manovra për të përdorur fondet e donatorëve → Më i cënueshëm ndaj ciklit politik → Rregulla rixhide shtetërore, p.sh. menaxhimi financiar	→ Varur nga fondeve të donatorëve → Ndikimi i donatorëve në politikat, zhvillimin e OJF

Duke marrë në konsideratë informacionin e vënë në dispozicion nga ana e ekspertëve në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Akademisë, u realizuan takime me grupin tematik dhe me grupin politik të punës.

Grupi tematik

Grupi tematik për shqyrtimin e mundësisë së krijimit të Akademisë, i përbërë nga drejtues të administratës vendore në disa nga bashkitë e vendit (Tiranë, Berat, Belsh, Dibër), konsideron se propozimi për ndritjen e Akademisë për pushtetin vendor vlerësohet nga të gjithë aktorët si i një rëndësie të vecantë për disa arsye :

- ✓ Bashkitë ndjejnë më shumë se kurrë nevojën për forcim kapacitetesh të stafit të tyre, vecanërisht në kushtet e hapjes së negociatave më BE, ku bashkitë kanë një rol të vecantë.

- ✓ Rritja e numrit të funksioneve dhe shërbimeve të ofruara nga ana e bashkive si dhe përdorimi gjithnjë në rritje i teknologjisë, ka bërë të domosdoshme nevojën për më shumë kualifikime.
- ✓ Në kushtet e rritjes së numrit të punonjësve të bashkive (rreth 39 000) , ASPA është në pamundësi reale për të realizuar trajnimin e të gjithë administratës vendore.
- ✓ Të zgjedhurit vendorë janë jashtë fushës së veprimtarisë së ASPA, ndërkohë që për shkak të vecorive të tyre si struktura politike, por edhe si struktura që ripërtërihen cdo 4 vjet, evidentojnë nevojën për kualifikimin e Kryetarëve të Bashkive, por edhe të Këshillave Bashkiake si organe përfaqësuese, vendimmarrëse dhe monitoruese të bashkisë.
- ✓ Bashkitë parashikojnë buxhete për forcim kapacitetesh, por në funsd të vitit ato mbeten të pashpenzuara megjithëse nevoja për trajnime është evidente. Kjo për shkak të legjislacionit që ka paqartësi në përdorimin e fondeve për forcim kapacitetesh. Krijimi i Akademisë do ta zgjidhte këtë problem, sepse këto buxhete mund të konsiderohen si kontribut i bashkive për Akademinë.
- ✓ Vecanërisht institucionet në vartësi të bashkisë dhe drejtues të tyre që nuk kanë statusin e nëpunësit civil, ndjejnë nevojën për forcim kapacitetesh për më shumë aftësi drejtuese dhe menaxhueve të institucioneve dhe ndërmarrjeve që ata drejtojnë.
- ✓ Përpjekjet e projekteve dhe organizatave ndërkombëtare dhe vendase, sic është rasti i Projektit Bashki të Forta, kanë treguar nevojën për krijimin dhe konsolidimin e strukturave të qendrueshme për trajnimin e të zgjedhurve dhe administratës vendore në sesione të vecanta dhe të përbashkëta për unifikimin e qëndrimeve dhe forcimin e bashkëpunimit.

Cështjet e dakordësuara në takimet e grupit tematik u prezantuan dhe u diskutuan në takimet e grupit politik, në përbërje të të cilit ka Kryetarë Bashkie me eksperiencë disa vjecare.

Grupi politik

Grupi politik konsiderohet i tillë për shkak të përbërjes së vet, si të zgjedhur vendorë. Gjithsesi diskutimi dhe opinioni i shprehur bazohet jo në preferenca politike, por tek nevoja që drejtuesit e bashkive kanë evidentuar në institucionet që drejtojnë prej disa mandatesh.

Përbërja e grupit politik që ka diskutuar në lidhje me ngritjen e Akademisë së pushtetit vendor është:

→ Z. Ervin Demo, Kryetar i Bashkisë Berat
→ Zj. Emirjana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës
→ Zj. Alma Hoxhaj, Kryetare e Bashkisë Përmet
→ Z. Andis Salla, Kryetar i Bashkisë Cërrik
→ Z. Erion Isai, Kryetar i Bashkisë Kolonjë

Në takimet e realizuara janë shtruar për diskutim opsione të ndryshme dhe janë diskutuar me përgjegjësi të lartë nga ana e pjesëmarrësve.

Cështjet e shtruara për diskutim janë :

- Nevoja për një Akademi për pushtetin vendor. Mbivendosje apo plotësim i nevojave?

- Forma e organizimit të Akademisë dhe përcaktimi se kush janë avantazhet dhe disavantazhet e Akademisë si Agjensi Shteterore dhe si OJF.
- Përcaktimi i qartë per ushtrimin e funksionit / kompetencës për standardet e funksionimit, financimit, monitorimit dhe kontrollit të veprimtarisë;
- Faza e tranzicionit përpara kalimit të funksionimit të Akademisë. A ka nevojë për një fazë tranzicioni apo mund të konsiderohet ngritja e menjëherëshme dhe funksionimi i saj?

Diskutimet në grupin politik kanë vlerësuar se:

→ Vetë ASPA pranon që nuk ka kapacitete të mjaftueshme për trajnime të mirefillta për të gjithe stafin e NJVQV dhe që nuk ka mundur ta realizojë këtë mision për vite me rradhë të veprimtarisë së saj.

→ Akademia shihet si institucioni i duhur që do ketë detyrimin te ofrojë trajnime në fusha specifike për nevoja të vecanta, mbi çfarë parashikon legjislacioni bazë dhe ai specifik për vetëqeverisjen vendore.

→ Kurrikulat për kualifikimin e administratës vendore kanë nevojë për rivlerësim dhe "updatim" në lidhje me zhvillimet e fundit dhe kjo nevojitet të realizohen në bashkëpunim dhe me mbështetjen e ASPA dhe ekspertizës që ajo zotëron. Ekspertizë e re nevojitet t'i bashkohet procesit.

→ Vlerësohet ngritja e Akademisë për shkak të kapaciteteteve dhe numrit të punonjësve dhe mënyrës së qasjes për të administruar gjithë procesin e punës së bashkisë, vecanërisht të kërkesave të propozuara nga Bashkimi Europian për mënyren e qasjes ndaj integrimit Europian.

→ Synohet që Akademia të ofrojë ekspertizë dhe konsulencë në kohë reale dhe dinamike, e cila do ndihmojë në unifikimin e praktikave, marrjen në kohë reale të konsulencave, përvec respektimit të një programi dinamik vjetor.

→ Objekt i punës së Akademisë nevojitet të jetë edhe asistenca e nevojshme teknike për Kryetarët e Bashkive.

→ Akademia mund të shërbejë për prezantimin e një praktikë shumë të mirë e një bashkie tek bashki të tjera, me qëllim replikimin e tyre dhe unifikim standardesh.

→ Konsiderohet me rëndësi bashkëpunimi me universitetet për të trajnuar punonjësit e bashkive, por edhe për të ofruar tek studentët mundësitë e bashkëpunimit dhe punësimit në të ardhmen.

→ Në sensin konceptual kjo strukturë që ne duhet të ngremë duhet të ketë fleksibilitet maksimal, duhet të ketë "pronësi' të qartë që bashkitë ta ndjejnë që akademia i përket dhe ju shërben atyre.

→ Midis dy propozimeve agjenci shteterore dhe strukturë e pavarur nga shteti propozohet një strukturë të pavarur nga shteti. Kjo do ishte një qasje më e mirë, duke parë variantet e propozuara.

→ Bashkitë kanë nevojë të rriten dhe forcohen institucionalisht dhe të jenë në gjendje të vetë-administrojnë nevojat e tyre, duke mos parë gjithmonë zgjidhjen tek qeveria qendrore. Ky është rasti të tregojmë që bashkitë janë të afta të përballen me problematika dhe janë të gatshme të marrim përsipër edhe pergjegjësitë se si t'i adresojnë këto problematika.

→ Parimi i "pronësisë" së Akademisë duhet të jetë i qartë. Një mundësi e mirë do të ishte që "pronësinë ta kenë bashkitë nëpërmjet shoqatave të të zgjedhurve vendorë. Nëpërmjet këtij përfaqësimi bashkitë mund të jenë pjesë e menaxhimit institucional dhe drejtimit të kësaj strukture. Detaje të organizimit dhe funksionimit mund të përcaktohen në aktin e themelimit dhe statutin e Akademisë, por e

rëndësishme është që "pronësia" të jetë e qartë dhe siguristh qeveria qendrore duhet të jetë partner i rëndësishëm i saj. Duhen krijuar hapsirat që sa më shumë partnerë të përfshihen me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së kësaj strukture.

→ Bashkitë kanë eksperienca të mira, eksperienca që kemi marrë nga bashkëpunimi me donatorë dhe projekte si BtF por edhe përmes veprimtarisë së ASPA. Përvoja na ka mësuar të kuptojmë cfarë kemi bërë mirë dhe çfarë duhet të bëjmë më mirë. Nevojitet të ketë sinergji shumë të qartë midis Akademisë dhe ASPA-ës në veprimtarinë e tyre.

→ Vecanërisht cështjet e buxhetimit dhe administrimit të financave vendore kërkojnë domosdoshmërisht kualifikime specifike të drejtuesve dhe administratës vendore.

→ Akademia nevojitet të ndërtojë një platformë të përdorshme lehtësisht jo vetëm për trajnime, por edhe për të ofruar asistencë për nevojat specifike që do ketë bashkia.

→ Konsolidimi dhe ndarja e praktikave të mira që kanë bashki të ndryshme duhet të jetë objekt i punës së Akademisë, ndërkohë që nuk ka qënë asnjëherë objekt i punës së ASPA.

→ Përdorimi i teknologjisë digjitale sjell avantazhe, kosto të ulët dhe fleksibilitet. Kurrikula ose asistenca vjen më e shpejtë dhe më specifike kur përdoret teknologjia. Trajnimet mund të bëhen të kombinuara, në auditore dhe online. Praktikat e mira nga institucione të ngjashme duhet të konsiderohen.

→ Në lidhje me periudhën e tranzicionit që propozohet 1-2 vite, duhet të konsiderojmë faktin që nevojat janë sot dhe veprimet duhen bërë shpejt. Ne mund ta krijojmë Akademinë dhe ta kemi në funksion në vitin 2025. Nëse ne kemi një ide të qartë duhet të kapin edhe parashikimet buxhetore të 2025 dhe të ndërtojmë një marrëdhenie të qartë me Ministrin për Pushtetin Vendor dhe Ministrinë e Financave.

Strukturat drejtuese

Strukturat drejtuese të Akademisë propozohet të jenë :

- Bordi vendimmarrës
- Drejtori Ekzekutiv

Qeverisja do të mund të sigurohet nga një Bord vendimmarrës që është përfaqësues i të gjitha palëve kryesore të interesit si:

- ✓ Shoqatat e të zgjedhurve vendorë
- ✓ Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor /AMVV-ja;
- ✓ DAP-i/ASPA;
- ✓ Bashkitë;
- ✓ Donatorët,
- ✓ Shoqëria civile
- ✓ Sektori privat
- ✓ Sektori universitar
- ✓ Aktorë të tjerë

Drejtori ekzekutiv zgjidhet nga Bordi sipas parashikimeve të Statutit dhe drejton veprimtarinë e Akademisë në përputhje me objektin e veprimtarisë dhe në zbatim të vendimmarrjes së Bordit.
Akadamia ka stafin e vet me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme sipas strukturës së miratuar nga Bordi, që garantojnë veprimtarinë për realizimin e misionit të saj.
Më shumë detaje përcaktohen në Aktin e Themelimit dhe statutin e Akademisë dhe në Regulloret e funksionimit të saj.

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Akademisë propozohet të jenë fushat e mëposhtme, por pa e kufizuar atë vetëm në këto aspekte të veprimtarisë:

→ *Trajnimi dhe zhvillimi* posaçërisht për stafin e vetëqeverisjes vendore (rreth 39 000)
- → Të zgjedhurit vendorë
- → Nëpunës civilë
- → Punonjës të institucioneve
- → Punonjës të ndërmarrjeve në vartësi

→ *Shërbime të tjera të mundëshme*
- → Ndarja e praktikave më të mira
- → Zhvillimi i rrjeteve në QV
- → Konferenca
- → Hulumtime /Kërkime,
- → Publikime
- → Menaxhimi i Njohurive
- → Partneritete Ndërkombëtare
- → Këshilla dhe Mbështetje nga Ekspertët
- → Asistim (coaching)

Avantazhet Akademi vs ASPA

Akademia duhet të justifikojë arsyet e krijimit të saj, krahasuar me atë cka sot ofrohet nga ana e ASPA. Në raport me veprimtarinë aktuale të ASPA, Akademia duhet të konsiderojë si avantazhe dhe objekt të punës së saj dallimet si vijon :

ASPA

→ Ndodhet në pamundësi për përballimin e nevojave për forcimi të kapaciteteve të administratës qendrore dhe vendore nga një istitucion i vetëm

→ E vetëdijëshme për nevoja në rritje për forcim kapacitetesh të NJVQV për shkak të shtimit të funksioneve dhe administratës së NJVQV

→ Evidenton vecori tepër specifike të nevojave të vecanta për forcim kapacitetesh të administratës vendore nga ato qendrore, që kërkojnë ekspertizë të shtuar.

→ Identifikon që ka kategori të përjashtuara nga kualifikimi që ofron ajo, sic është rasti i të zgjedhurve vendorë, i punonjësve të institucioneve dhe ndërmarrjeve në vartësi të bashkisë pa status të nëpunësit civil

→ Konstaton se një institucion në vartësi të qeverisë mund të mos jetë forma më e përshtatshme për ofrimin e trajnimeve për të zgjedhur vendorë , përfaqësues të forcave të ndryshme politike në pozitë dhe opozitë

Akademia

→ E aftë të evidentojë nevojat specifike për kualifikime të NJVQV

→ Plotëson më mirë nevojat e evidentuara duke patur fokus të vetëm problematikat e NJVQV

→ Përfshin të gjitha kategoritë e stafit dhe të zgjedhurve vendorë, me status të nëpunësit civil dhe pa status.

→ Realizon një bashkëpunim më të mirë me shoqatat e të zgjedhurve vendor për shkak të objektit të veprimtarisë dhe fokusit të përbashkët të tyre.

→ Siguron gjithëpërfshirje, vecanërisht të të zgjedhurve vendorë të forcave të ndryshme politike.

→ Akademia e pavarur krijon pavarësi dhe është më e qëndrueshme ndaj zhvillimeve politike në nivelin qendror

→ Nxit shkëmbimin e historive të suksesit dhe praktikave të mira nëpërmjet krijimit të platformave dhe rrjeteve të përbashkëta të NJVQV

→ Mbështet reformat dhe decentralizimin e realizuar nga qeveria dhe parlamenti, nëpërmjet mbështetjes së bashkive me asistencën e nevojshme teknike.

Bashkëpunimi dhe partneriteti

Në veprimtarinë e vet Akademia do duhet të bashkëpunojë ngushtë me institucione dhe organizata partnere vendase dhe të huaja.
Akademia do të duhet të identifikojë dhe sigurojë partneritet me :

→ AMVV - për të pasur qasje në ekspertizë dhe këshilla reciproke si dhe për të mbështetur rolin e AMVV në çështjet legjislative, rregullatore dhe të zhvillimit institucional të NJVQV-ve

→ ASPA - për të siguruar që shërbimet e ASPA dhe Akademise plotësojnë njëri tjetrin, shkëmbejnë ekspertizë, trajnerë, ndajnë materiale, ndajnë potencialisht platforma mësimore dhe infrastruktura të tjera të vecanta dhe të përbashkëta.
→ Shoqatat e NJQV-ve – për një evidentim më të mirë nevojash, ndarrje materiale, praktika të mira, listë ekspertësh, publikime, etj.
→ Agjencitë donatore - për të aksesuar mjetet, programet, mbështetjen e qeverisjes vendore dhe për të bashkërenduar përpjekjet
→ Ministritë dhe agjencitë e tjera qeveritare me qëllim përmbushjen e funksioneve specifike nga ana e NJVQV.
→ Partnerët ndërkombëtarë – vecanërisht për cështje që lidhen me integrimin në BE.
→ Partnerë të tjerë më veprimtari në fushën e vetëqeverisjes vendore

Qëndrueshmëria financiare

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së Akademisë është cështja e financimit dhe qëndrueshmërisë financiare.

→ Bazuar në krahasimin me institucionet ekzistuese dhe madhësinë e propozuar të Akademisë (7-10 anëtarë stafi fillimisht) niveli i përgjithshëm i financimit të kërkuar parashikohet të jetë në nivelin prej 350,000 deri në 450,000 euro.

→ Nevojitet të analizohet paraprakisht mënyra e financimit të Akademisë. Kjo duhet të bazohet në financimin e kombinuar nga NJVQV dhe Qeveria Qendrore, me potencial për financim nga donatorët në fazën e themelimit dhe në vijim.

→ Alokimi i fondeve qendrore mund të jetë më i lartë në vitet e para me synimin për një ekualizim me faza me kontributin e NJVQV-në (50:50 qendrore-vendore) për një periudhë të dakordësuar tranzitore, për të kaluar në fazën e financimit në raport 60% nga NJVQV dhe 40% nga Qeveria Qendrore.

→ Nevojitet të dakordësohet dhe vendoset mënyra e përllogaritjes së kontributit nga bashkitë**,** pëmes një formule të dakordësuar, që bazohet në numrin e punonjësve, ose bazën e të ardhurave të secilës bashki. Kontributi i NJVQV mund të jetë pjesë e transfertës vjetore për NJQV-të. Do të nevojitet që të shqyrtohen skenarë të ndryshëm në lidhje me kontributin e secilës bashki.

→ Kostot e përgjithëshme të funksionimit të Akademisë konsiderohen të përballueshme nga ana e 61 Bashkive, bazuar ne buxhetet e bashkive dhe numrin e tyre.
→ Konsiderohet i rëndësishëm një startim i suksesshëm i themelimit dhe fillimit të aktivitetit duke garantuar pjesëmarrjen dhe dakordësinë e të gjitha bashkive.
→ Sfida kryesore e Akademisë do të jetë partneriteti me institucione, organizata partnere dhe donatorë duke krijuar besueshmëri dhe garantuar financim të programeve.

Faza tranzitore

Shoqata për Autonomi Vendore konstaton se Akademia mund të ngrihet dhe të fillojë funksionimin e saj në një kohë relativisht të shkurtër, që përkon me vitin 2025. Nëse hapat e nevojshmë realizohen në muajt në vijim, buxheti i shtetit dhe buxhetet e bashkive për vitin 2025 mund të parashikojnë kontributet përkatëse për Akademinë, duke bërë të mundur që aktiviteti i saj të fillojë brenda vitit 2025, e asistuar dhe e mbështetur në hapat e parë nga SHAV dhe AMVV dhe në bashkëpunim të gushtë me ASPA për kalimin e funksioneve të saj tek Akademia.

Edhe mundësia e administrimit të Akademisë nga ana e AMVV në një faqë të shkurtër tranzitore, mund të merret në konsideratë.

Ky material u përgatit me mbështetjen e HELVETAS Sëiss Intercooperation.